



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L –144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 20, paragrafi 2 të Rregullores QRK nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe të nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

#### V E N D I M

#### **PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS FONDACIONIT PËR MBROJTJEN E KAFSHËVE “VIER PFOTEN”**

- I.** Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve “Vier Pfothen”, e përfaqësuar nga kryetari i fondacionit, z. Helmut Dangler, pa procedurë të rregullt konkurrimi.
- II.** Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika: parcela kadastrale nr. 00035-0, Zona kadastrale Novosellë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2120 m<sup>2</sup>, pasuri shoqërore, Kuvendit komunal Prishtinë.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është ndërtimi i strehimores së arinjve dhe shtazëve të tjera të egra.
- IV.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është afatgjatë, për 99 vjet.
- V.** Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.



**IX.** Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:

- skica grafike,
- kopja e planit dhe certifikata e pronësisë.

**X.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-463/01-0263733/18, më 01.11.2018**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp is blue and contains the text 'KOMUNË E PRISHTINËS' at the top, 'KRYESUESI I KUVENDIT' in the center, and 'PRISHTINA' and 'KOSOVA' at the bottom. The signature is written in a cursive style.